

20120842206

**L I G J**  
**PËR GARANCI TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE NDAJ DETYRIMEVE SIPAS MARREVESHJES FINANCIARE, TË DEDIKUAR PËR FINANCIM TË NDERMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE PROJEKTEVE TJERA PRIORITARE- FAZA III, E CILA DO TË LIDHET NDERMJET BANKES INVESTUESE EVROPIANE DHE BANKES MAQEDONASE PËR MBESHTETJE TË ZHVILLIMIT**

Neni 1

Republika e Maqedonise e garanton shlyerjen e detyrimeve nga Marreveshja financiare për sigurim të huas për Projektin për financimin e ndermarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare - faza III në shume prej 100.000.000 eurosh, e cila do të lidhet ndermjet Bankes Investuese Evropiane dhe Bankes Maqedonase për Mbeshtetje të Zhvillimit, nese Banka Maqedonase për Mbeshtetjen e Zhvillimit nuk i shlyen dhe servison detyrimet në afatet dhe kushtet e parapara në Marreveshjen financiare.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshje financiare, e cila do të lidhet ndermjet Bankes Investuese Evropiane dhe Bankes Maqedonase për Mbeshtetjen e Zhvillimit për Projektin për financim të ndermarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare - faza III.

Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që dalin nga Marreveshja financiare nga neni 1 i ketij ligji, do t'i servisoje Banka Maqedonase për Mbeshtetje të Zhvillimit.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i ketij ligji do të terhiqet në më së shumti 23 transhe. Shuma minimale e transhese eshte 3.000.000 euro.

Afati i pageses së seciles transhe të huas mund të jete nga së paku kater vjet deri në më së shumti tete vjet nga data e terheqjes së transhese, me grejs periudhe të perfshire që mund të jete ndermjet 60 ditesh dhe dy vjetesh nga data e terheqjes së transhese.

Afati i pageses së huas do të percaktohet për secilen transhe veç e veç në ditën e dorezimit të kerkeses për terheqjen e mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbeshtetje të Zhvillimit.

Transheja mund të paguhet edhe pernjehere në ditën e cila eshte ndermjet tre dhe pese vjetesh nga dita e terheqjes së transhese.

Neni 5

Shkalla kamatore do të percaktohet për secilen transhe të huas veç e veç, në ditën e dorezimit të kerkeses për terheqjen e mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbeshtetjen e Zhvillimit, varesisht nga ajo se cila shkalle kamatore eshte më e volitshme për Republikën e Maqedonise (fikse apo variable).

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella, të cilat dalin nga Marreveshja financiare dhe Marreveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Banka Maqedonase për Mbeshtetje të Zhvillimit do të lidhin marreveshje të vecante.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".